



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2025/0654

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga U.D Kryetari i Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (LPP) në përbërje nga Vedat Poterqoi - Kryetar, duke vendosur sipas ankesës së Operatorit Ekonomik (OE) “Gentian Sakaj” B.I. kundër Vendimit për anulimin e procedurës së prokurimit të Komuna e Rahovecit në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK) lidhur me aktivitetin e prokurimit Mirëmbajtja dhe Servisimi i automjeteve me numër të prokurimit:623-25-4014-2-2-1, me 05/09/2025, mori:

Vendim

1. Aprovohet, si pjesërisht e bazuar ankesa e OE “Gentian Sakaj” B.I. me nr. 2025/0654 , e datës 16/07/2025, lidhur me aktivitetin e prokurimit Mirëmbajtja dhe Servisimi i automjeteve me numër të prokurimit: 623-25-4014-2-2-1.
2. Anulohet në tërësi aktiviteti i prokurimit Mirëmbajtja dhe Servisimi i automjeteve me numër të prokurimit 623-25-4014-2-2-1 në mungesë të ofertave të përgjegjshme. Nëse AK më tutje ka interes për aktivitetin e prokurimit mund ta ri tenderojë.
3. Në afat prej 10 ditësh, AK duhet ta informojë OSHP për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, në të kundërtën, OSHP ka të drejtë të ndërmarrë masa ndaj AK për mos respektim të vendimit sikurse parashihet me dispozitat e nenit 131 të LPP.
4. Kthehen mjetet e deponuara në emër të taksës tarifore për parashtrimin e ankesës në llogarinë e Operatorit Ekonomik “Gentian Sakaj” B.I.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale –

Me 12/05/2025, Komuna e Rahovecit në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar Njoftimin për Kontratë B05 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull Mirëmbajtja dhe Servisimi i automjeteve me numër të prokurimit 623-25-4014-2-2-1.

Ndërsa me datën 02/07/2025 ka publikuar B58 Njoftimin mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues ku ka shpërblyer me kontrate N.SH.T. “Neziri – N” ne vlere totale te ofertës 25,693.76 Euro.

Ky aktivitet i prokurimit është zhvilluar me procedurë të hapur me llojin e kontratës shërbime dhe me vlerë të parashikuar të kontratës 60,000.00 €

Me 06/07/2025, OE “Gentian Sakaj” B.I. ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër vendimit të lartcekur të AK. Autoriteti Kontraktues e ka refuzuar si te pabazuar kërkesën për rishqyrtim.

Me 16/07/2025, OSHP ka pranuar ankesën nga OE “Gentian Sakaj” B.I. me nr. 0654/2025 lidhur me aktivitetin Mirëmbajtja dhe Servisimi i automjeteve me numër të prokurimit: 623-25-4014-2-2-1.

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

OSHP ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues “Gentian Sakaj” B.I. janë parashtruar si në vijim:

Pretendimi 1:

Së pari duhet të sqarojmë se Autoriteti Kontraktues në paramasën apo përshkrimin e çmimit " Përshkrimi i Çmimeve - Mirëmbajtja dhe servisimi i automjeteve " ka paraqitur një listë të makinave dhe automjeteve për të cilat është dashur që të jepen çmimet për të gjitha pjesët e makinave, për secilin lloj veture veç e veç nga Grupi A nr. 1 deri tek Grupi D nr. 55 dhe OE janë të obliguar që të plotësojnë TË GJITHA rubrikat e çmimeve për secilin automjet sipas kategorive përveç atyre të shënuara me X. OE i propozuar për kontratë në pozicionin B MIRËMBAJTJA DHE PJESËT REZERVE (KATEGORIA B), Pozicioni nr. 158 - Shpaneri i jashtëm I zingjirit (shpaneri-shtrenguesi I zingjirit) nuk ka vendos çmim fare. Bazuar në UDHËZUES Nr. 002/2024, PËR PLOTËSIM NDRYSHIMIN E UDHËZUESIT Nr. 001/2023 PËR PROKURIMIN PUBLIK, Pika “10. Sqarimi i tenderëve gjatë procesit të vlerësimit të tenderëve”, Komisioni i Vlerësimit është duhur ta refuzonte tenderin pa kërkuar informacion të mëtejshëm sepse nuk është plotësuar Kushti administrativ. Si përfundim në rastin konkret është e pamundur të kryhet pagesa në bazë të çmimeve të ofertuara për faktin se oferta e OE të rekomanduar për kontratë në një pozicion NUK KA VENDOS ÇMIM fare çka e bën ofertën e papërgjeshme dhe kontratën e pa realizueshme. OE i rekomanduar për kontratë pasi që nuk e ka plotësuar Kushtin Administrativ, është duhur të shpallet si palë jashtë interesit për këtë tender.

Pretendimi 2:

Pas administrimit dhe shqyrtimit të shkresave të lëndës, sqarojmë se OE i rekomanduar për kontratë ka dorëzuar ofertë me çmime manipulative për disa pozicione. OE i rekomanduar për kontratë prej 321 pozicioneve sa janë gjithsej në paramasë në 217 prej tyre (mbi 67%) ka vendos çmimin 0.01 euro, çmime këto jo-normalisht të ulëta. Në sqarimin e ofruar për këto çmime nga OE i propozuar për kontratë, sqaron se këto çmime janë vendosur nëpër pozicione ku nuk kanë nevojë për ndrrim apo servisim dhe si përfundim në rastin konkret OE i rekomanduar për kontratë N.SH.T. “NEZIRI-N” ka qenë në dijeni se cilat automjete nuk kanë nevojë për servise prandaj dhe ka vendos çmime manipulative.

Pretendimi 3:

OE i rekomanduar për kontratë N.SH.T. “NEZIRI-N” ka dorëzuar ofertë me çmime shumë manipulative për shumë pozicione. OE i rekomanduar për kontratë për punën e njëjtë ka ofertuar me çmime të ndryshme si vijon: Në pjesën e parë: A - SERVISIMI RREGULLT, për automjetet Autobus Mercedes Benz 0303--13 R, Autobus Mercedes Benz 0303-13 R dhe Kombi Hyundai H 100 ka vendos çmim prej 0.01 euro per servise dhe rregllazha. Në pjesën e dytë: B MIRËMBAJTJA DHE PJESËT REZERVE - Poz. 1 – Antifrizi Antifriz G 12, OE i rekomanduar për kontratë për disa automjete ka vendos çmim pre 0.01 euro për 1 litër që është çmim ekstremisht i ulët (kur dihet se 1 litër Antifriz në treg vetëm furnizimi është 1.50 euro minimum), ndërsa në disa automjete tjera ka vendos çmim 5.00 që është çmim ekstremisht i lartë. Metodën për çmime manipulative e ka përdor pothuaj në secilin pozicion. Në poz. 5 Reduktori, Pjesa B MIRËMBAJTJA DHE PJESËT REZERVE, OE i rekomanduar për kontratë për disa automjete ka vendos çmim pre 0.01 euro për Reduktor që është çmim ekstremisht i ulët (kur dihet se Reduktori vetëm furnizimi është 100.00 euro minimum), ndërsa në disa automjete tjera ka vendos çmim 250.00 që është çmim ekstremisht i lartë. Si përfundim në rastin konkret pasi që OE i rekomanduar për kontratë N.SH.T. “NEZIRI[1]N” ka vendosur çmime manipulative për të zbritur Çmimin e Përgjithshëm i peshuar dhe dyshojmë se ka qenë në dijeni se cilat automjete realisht kanë nevojë për servisim dhe ka vendosur çmim astronomik të lartë ndërsa për ato automjete që nuk kanë nevojë për servisim (riparim) ka vendos çmim jo normalisht të ulët.

Pretendimi 4:

Sipas FDT-së: Kapaciteti teknik dhe professional: Kërkesa 1: Operatori Ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka realizuara me sukses kontrata të natyrës së ngjashme, në tri vitet e fundit nga data e publikimit të Njoftimit për Kontratë, në vlerë min. 90,000.00 Euro; OE i rekomanduar për kontratë N.SH.T. “NEZIRI-N” ka dorëzuar listën me kontratat e natyrës së ngjashme që nga viti 2008, mirëpo për tri vitet e fundit ka të realizuar shumë prej 88,038.26 euro. Ky kriter nuk është i plotësuar nga OE i propozuar për kontratë.

Pretendimi 5:

Sipas FDT-së: Kapaciteti teknik dhe profesional: Kërkesa 2: Kërkesa 2: Numri i punëtorëve të angazhuar në këtë projekt, min. 5 punëtor me të dhënat në vijim: Emri, mbiemrin, mosha e punëtorit, profesioni, eksperiencia (vite) dhe pozicioni në kompani; OE i rekomanduar për kontratë N.SH.T. "NEZIRI-N" ka dorëzuar listën me punëtorë ku në listë janë të specifikuar 5 punëtorë. Ky kriter nuk është i plotësuar nga OE i propozuar për kontratë sepse punëtori Tefik Neziri është i përfshirë në kriterin 3, që duhet të largohet nga lista ndërsa në listë mbesin 4 punëtorë. Bazuar në këto 5 pretendime Autoriteti Kontraktues në mënyrë të kundërligjshme ka shpallur Fitues një operator ekonomik i cili nuk ka përmbushur kërkesat në dosjen e tenderit dhe njoftimit për kontratë. Në lidhje me eliminimin e kompanisë sonë: AK me eliminimin tonë nga ky tender ka përdoruar standarde të dyfishta, ku për ato gjetje që ka eliminuar ofertën tonë ndërsa OE N.SH.T. "NEZIRI-N" ia ka pranuar pa i plotësuar ato kritere. Me rastin e eliminimit të kompanisë sonë duke mos kërkuar sqarim, shihet qartas që ka vepruar në kundërshtim me Rregulloren nr.002/2024 për plotësimin dhe ndryshimin e rregullores nr.001/2022 për prokurimin publik 40.13-Duke mos bërë vlerësimin dhe krahasimin e tenderëve sipas kritereve për dhënien e kontratës të përcaktuara në njoftimin e kontratës/dosjen e tenderit. Ndërsa, duke e ditur që ne si tenderues kemi ofruar ofertën më të mirë sipas kritereve për dhënien e kontratës, në bazë të Rregullores për prokurim publik, 45.33, Autoriteti Kontraktues ka vazhduar vlerësimin e ofertës jashtë kritereve të cilat nuk kanë qenë të vendosura në dosjen e tenderit dhe njoftimin për kontratë. Ndërsa nën 59.4 i LPP-së gjithashtu lejon Autoritetin Kontraktues që të pranojë ofertat, në rast të gabimeve ose paqartësive dhe në raste të devijimeve të vogla. Në të dyja rastet është një kusht që të mos jetë në aspektin material të njoftimit për kontratë/dosjen e tenderit nuk janë prekur. Ndërsa duke u bazuar në Nenin 59-Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i tenderëve pika.2 AK ka mundur që të kërkojë sqarim me shkrim mbi cilindo nga aspektet e tenderit, në mënyrë që të bëhet Ekzaminimi, Vlerësimi ose Krahasimi i tenderëve sipas Ligjit, Udhëzuesëve dhe Rregulloreve. Komisioni i vlerësimit me rastin e vlerësimit ka bërë shkeljen e deklaratës nën betim Sipas Neneve 1,11, 59 dhe 72 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 duke mos zbatuar detyrën për të cilën edhe e ka nënshkruar këtë deklaratë duke eliminuar kompaninë tonë për kritere të cilat mund të kërkohej sqarim. Me eliminimin tonë nga ky aktivitet i prokurimit dhe me shpalljen fitues të OE, AK e ka favorizuar drejt për se drejt OE të rekomanduar për kontratë ndërsa na ka diskriminuar dhe na ka dëmtuar neve drejtpërsëdrejti. Autoriteti kontraktues në këtë aktivitet të prokurimit nuk ka pasur në konsideratë Nenin 1 të LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë. Me këtë veprim AK ka bërë shkelje të nenit 1 të LPP-së ku thuhet se: vendimet e AK-ve, të mos ndikohen nga interesat personale, të karakterizohet me jodiskriminim dhe me një shkallë të lartë të transparencës dhe, të jenë në përputhje me kërkesat procedurale dhe qenësore të këtij ligji. Pra ne kemi dorëzuar tender i cili është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin për kontratë dhe dosje të tenderit dhe kemi ofertuar me tenderin me çmim më të ulët.

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Paneli Shqyrtues me datë 16/07/2025 ka autorizuar ekspertin për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 0654/2025, ndërsa me datë 23/07/2025 është dorëzuar raporti i ekspertit me nr. 0654/2025, me rekomandimet si në vijim: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet pjesërisht si e bazuar, për arsye të dhëna në pretendimin me numër një, ndërsa propozoj të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës, dhe nëse AK më tutje ka interes aktivitetin e prokurimit mund ta ri tenderoj.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave –

Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova raportin e ekspertit, mendimet e palëve lidhur me raportin e ekspertit, parashitjet dhe dokumentet e ankuesit, shkresat dhe dokumentet e autoritetit kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Lidhur me pretendimet e OE “Gentian Sakaj” B.I. eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2025/0654 ka vlerësuar si në vijim:

Autoriteti Kontraktues Komuna e Rahovecit, për këtë aktivitet të prokurimit ka zbatuar procedurë të hapur, kontratë publike kornizë shërbim. Vlera e parashikuar e kontratës është: 60,000.00 €. Ndërsa, kriteri i dhënies së kontratës është “Tenderi i përgjegjshëm me Çmimin më të ulët me poentim”.

Sqarim hyrës: Pas administrimit dhe shqyrtimit të shkresave të lëndës kundrejt pretendimeve ankimore, sqarojmë se operatori ekonomik ankues pretendon se AK ka vepruar në kundërshtim me nenin 1, 6, 7, dhe 61 të LPP-së, si dhe shkelje të dispozitave të Rregullores Nr.002/2024, për plotësimin dhe ndryshimin e Rregullores Nr.001/2022 për Prokurim Publik, konkretisht të nenit 41 të Rregullores, si dhe nenin 10 të Udhëzuesit Nr. 002/2024 , për plotësimin dhe ndryshimin e Udhëzuesit Nr. 001/2023 për Prokurim Publik.

Pretendimet ankimore kanë të bëjnë kundër njoftimit për dhënie të kontratës, si dhe kundërt eliminimit të ofertës së OE ankues. Ankesa e OE ankues, më saktë pretendimet ankimore janë shqyrtuar nga ekspertja duke u bazuar në shkresat e lëndës, ndërsa jep përgjigjet si në vijim.

Pretendimi ankimor 1: OE ankues potencon se Autoritetit kontraktues në paramasë apo përshkrimin e çmimeve ka paraqitur një listë të makinave dhe automjeteve për të cilat është dashur që të jepen çmimet për të gjitha pjesët e makinave për secilën lloj veture veç e veç nga Grupi A nr.1 deri tek Grupi D nr.55 dhe operatorët ekonomik janë të obliguar ti plotësojnë të gjitha rubrikat e çmimeve për secilin automjet sipas kategorive përveç atyre të shënuara me X. Tutje OE ankues potencon se OE i rekomanduar për kontratë në pozicionin B Mirëmbajtja dhe pjesët rezerve (kategoria B) Pozicioni nr.158-Shpaneri i jashtëm i zingjirit (shpaneri-shtrenguesi i zingjirit) nuk ka vendos çmim fare. OE i rekomanduar për kontratë bazuar në piken 10 të UDHËZUESIT Nr. 001/2023 PËR PROKURIMIN PUBLIK nuk e ka plotësuar Kushtin Administrativ, dhe është duhur të shpallet si palë jashtë interesit për këtë tender.

Përgjigje në pretendimin ankimor 1: Ekspertja shqyrtuese sqaron në lidhje me këtë pretendim ankimor, vet AK në përgjigje të kërkesës për ri shqyrtim e pranon që të ky pozicion është bërë gabim teknik pasi që është dashur të vendoset simboli X. Megjithatë edhe vet AK e pranon që është bërë gabim, ekspertja shqyrtuese konsideron se paramasa duhet të plotësohet në tërësi dhe nuk lejohet që të bëhen lëshime të tilla në emër të gabimit teknik për shkak se mos vendosja e çmimeve është kusht administrativ sipas UDHËZUES NR. 002/2024, PËR PLOTËSIM NDRYSHIMIN E UDHËZUESIT NR. 001/2023 PËR PROKURIMIN PUBLIK, pika 10.1:

Andaj, pretendimi ankimor është i bazuar.

Pretendimi ankimor 2: OE ankues potencon se OE i rekomanduar për kontratë N.SH.T “Neziri-N”- Rahovec, ka dorëzuar ofertë me çmime manipulative për shumë pozicione, i njëjti prej 321 pozicioneve sa janë gjithsej në paramasë në 217 prej tyre (mbi 67%) ka vendos çmimin 0.01 euro, çmime këto jo-normalisht të ulëta. Në sqarimin e ofruar për këto çmime nga OE i rekomanduar për kontratë, sqaron se këto çmime janë vendosur nëpër pozicione ku nuk kanë nevojë për ndërrim apo servisim. OE ankues pretendon se i njëjti ka qenë në dijeni se cilat automjete nuk kanë nevojë për servise prandaj dhe ka vendosur çmime manipulative.

Përgjigje në pretendimin ankimor 2: Ekspertja shqyrtuese bazuar në shkresat e lëndës sqaron se AK përmes “Letrës Standarte kërkesës për informata mbi tenderët jo-normalisht të ulët” ka kërkuar nga OE N.SH.T “Neziri-N”- Rahovec, sqarim lidhur me pozicionet e artikujve ku sipas përshkrimit të çmimeve shumica e pozicioneve janë me çmime 0.01 euro. OE N.SH.T “Neziri-N”- Rahovec, me datë 26.06.2025, përmes shkresës ju ka përgjigjur AK lidhur me çmimet e pozicioneve prej 0.01 euro, duke deklaruar se garantojnë për të gjitha pozicionet që kanë ofertuar se janë në harmoni me çmimet e tregut dhe kanë kapacitet të realizojnë me çmimet e ofruara.

Ekspertja shqyrtuese sqaron se AK ka respektuar dispozitat e nenin 61 të LPP-së, duke kërkuar sqarime lidhur me çmimet abnormalisht të ulëta nga OE i rekomanduar për kontratë. Të njëjtit kanë marr shpjegimin nga Operatori Ekonomik i rekomanduar për kontratë, dhe AK është bindur lidhur me këto sqarime të operatorit ekonomik, vlerësimi i këtyre sqarimeve është në diskrecionin e autoritetit kontraktues i cili vendos nëse do të bazohet apo jo në to, pasi AK para se të inicioj një aktivitet të prokurimit ka për obligim që të hulumtoj tregun dhe të siguroj informatat e nevojshme për produktet apo shërbimet të cilat i prokuron.

Për më tepër, dispozitat e nenit 61 të LPP-së dhe pika 4.6 e Rregullave për tender jo-normalisht të ulët i ka jep këtë kompetencë, AK-së si më poshtë:

Rregullat për Tenderët Jo-Normalisht të Ulët konkretisht nenit 4 të këtyre rregullave Procedura e shqyrtimit (inter partes). Gjithashtu, neni 4.6 pika 1 dhe 2 kanë përcaktuar.

4.6 Pasi që Autoriteti kontraktues merr shpjegimin me shkrim nga Operatori Ekonomik, Autoriteti Kontraktues duhet ose:

4.6.1 Nëse sqarimi është i mjaftueshëm, të trajtoj tenderin njëjtë me tenderët tjerë; ose

4.6.2 Nëse sqarimi nuk mjafton, të refuzoj tenderin dhe, në përputhje me nenin 61 të LPP-se të njoftoj KRPP, duke përdorur formën standarde të miratuar nga KRPP, “Njoftim për refuzim të

tenderit abnormalisht të ulët”, brenda dy dite nga data e vendimit.

Andaj, ekspertja shqyrtuese konsideron se pretendimi i OE ankues është i pabazuar.

Pretendimi ankimor 3: OE ankues potencon se OE i rekomanduar për kontratë N.SH.T “Neziri-N”- Rahovec, ka dorëzuar ofertë me çmime manipulative për shumë pozicione për punët e njëjta ka ofertuar me çmime të ndryshme.

Në pjesën e parë: A - SERVISIMI RREGULLT, për automjetet Autobus Mercedes Benz

0303--13 R, Autobus Mercedes Benz 0303-13 R dhe Kombi Hyundai H 100 ka vendos çmim prej 0.01 euro për servise dhe rregllazha. Në pjesën e dytë: B MIRËMBAJTJA DHE PJESËT REZERVE - Poz. 1 – Antifrizi Antifriz G 12, OE i rekomanduar për kontratë për disa automjete ka vendos çmim pre 0.01 euro për 1 litër që është çmim ekstremisht i ulët (kur dihet se 1 litër Antifriz në treg vetëm furnizimi është 1.50 euro minimum), ndërsa në disa automjete tjera ka vendos çmim 5.00 që është çmim ekstremisht i lartë.

Metodën për çmime manipulative e ka përdor pothuaj në secilin pozicion. Në poz. 5 Reduktori, Pjesa B MIRËMBAJTJA DHE PJESËT REZERVE, OE i rekomanduar për kontratë për disa automjete ka vendos çmim pre 0.01 euro për Reduktor që është çmim ekstremisht i ulët (kur dihet se Reduktori vetëm furnizimi është 100.00 euro minimum), ndërsa në disa automjete tjera ka vendos çmim 250.00 që është çmim ekstremisht i lartë.

Si përfundim në rastin konkret pasi që OE i rekomanduar për kontratë N.SH.T. “NEZIRIN” ka vendosur çmime manipulative për të zbritur Çmimin e Përgjithshëm i peshuar dhe dyshojmë se ka qenë në dijeni se cilat automjete realisht kanë nevojë për servisim dhe ka vendosur çmim astronomik të lartë ndërsa për ato automjete që nuk kanë nevojë për servisim (riparim) ka vendos çmim jo normalisht të ulët.

Përgjigje në pretendimin ankimor 3: Ekspertja shqyrtuese lidhur me këtë pretendim ka dhënë përgjigje në pretendimin numër dy. Ndërsa, lidhur me pretendimi se OE i rekomanduar për kontratë “ka qenë në dijeni se cilat automjete realisht kanë nevojë për servisim dhe ka vendosur çmim astronomik të lartë ndërsa për ato automjete që nuk kanë nevojë për servisim (riparim) ka vendos çmim jo normalisht të ulët.”, ekspertja shqyrtuese konsideron se ky pretendim ankimor nuk ka të bëjë me çështje në të cilën mund të japim përgjigje sepse i gjithë vlerësimi jonë duhet të bazohet në shkresa/prova dhe argumente për secilën përgjigje që japim por nëse OE ankues ka argumente apo konsideron se mund ta dëshmojë këtë pretendim, mundë ti drejtohet organeve tjera kompetente.

Pretendimi ankimor 4: OE ankues potencon se sipas FDT-së: Kapaciteti teknik dhe profesional: Kërkesa 1: Operatori Ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka realizuara me sukses kontrata të natyrës së ngjashme, në tri vitet e fundit nga data e publikimit të Njoftimit për Kontratë, në vlerë min. 90,000.00 Euro;

OE i rekomanduar për kontratë N.SH.T. “NEZIRI-N” ka dorëzuar listën me kontratat e natyrës së ngjashme që nga viti 2008, mirëpo për tri vitet e fundit ka të realizuar shumën prej 88,038.26 euro. Ky kriter nuk është i plotësuar nga OE i propozuar për kontratë.

Përgjigje në pretendimin ankimor 4: Ekspertja shqyrtuese sqaron se autoritetit kontraktues tek kërkesat e Kapaciteti teknik dhe profesional ka kërkuar:

Kërkesa 1: Operatori Ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka realizuara me sukses kontrata të natyrës së ngjashme, në tri vitet e fundit nga data e publikimit të Njoftimit për Kontratë, në vlerë min. 90,000.00 Euro;

Dëshmia e kërkuar dokumentare: *Dëshmia 1: Lista e shërbimeve të realizuara, duke plotësuar ANEKSIN 8 të Dosjes së Tenderit, në lëmin e shërbimeve të ngjashme të realizuar në tri vitet e fundit nga data e publikimit të Njoftimit për Kontratë – duhet të dorëzohet në origjinal, i nënshkruar dhe i vulosur nga Operatori Ekonomik, DHE kësaj liste duhet ti bashkëngjiten si dëshmi*

(i) kur shërbimi është bërë për një Autoritet Publik në Kosovë ose në një vend tjetër, për dëshmi të këtij livrimi shërben kopja e certifikatës (certifikata/raporti i përkohshëm i pranimit) të rëndësishme të lëshuar ose të bashkë-nënshkruara nga autoriteti i tillë, të gjitha këto dëshmi duhet të kenë vlerën e realizuar,

(ii) kur shërbimi është bërë për një blerës privat, për dëshmi të këtij livrimi shërben kopja e çdo dokumenti të nënshkruar nga blerësi dhe evidentimi i livrimit të tillë me dëshmi të pagesës nga banka;

Lidhur me kërkesë të AK-së, OE i rekomanduar për kontratë N.SH.T “Neziri-N”- Rahovec, së bashku me ofertë ka bashkangjitur dokumentin me titull: 6.Kapaciteti teknik dhe profesional. Kërkesa 1.pdf. Bazuar në listën e kontratave janë prezantuar edhe kontrata jashtë periudhës në tri vitet e fundit nga data e publikimit të njoftimit për kontratë. Kurse, periudha në tri vitet e fundit është nga data 13.05.2022-13.05.2025. Por në këtë listë ka edhe kontrata brenda periudhës në tri vitet e fundit, si kontrata me numër të protokollit 3512 e datës 14.07.2021 dhe referenca për këtë kontratë me numër 2205, në vlerë prej 59,892.94 euro, si dhe kontrata me numër të protokollit 2959 e datës 17.07.2023 e dëshmuar me referencën me numër 1803 me vlerë prej 60,000.00 euro. Pra, vetëm këto dy kontrata mbulojnë kërkesën e AK-së, prej 90 mijë euro (në tri vitet e fundit nga data e publikimit të Njoftimit për Kontratë, në vlerë min. 90,000.00 Euro;)

Andaj, pretendimi ankimor i OE ankues është i pabazuar.

Pretendimi ankimor 5: OE ankues potencon se sipas FDT-së: Kapaciteti teknik dhe profesional: Kërkesa 2: Kërkesa 2: Numri i punëtorëve të angazhuar në këtë projekt, min. 5 punëtor me të dhënat në vijim: Emri, mbiemrin, mosha e punëtorit, profesioni, eksperiencia (vite) dhe pozicioni në kompani; OE i rekomanduar për kontratë N.SH.T. "NEZIRI-N" ka dorëzuar listën me punëtorë, ku në listë janë të specifikuar 5 punëtorë. Ky kriter nuk është i plotësuar nga OE i propozuar për kontratë sepse punëtori Tefik Neziri është i përfshirë në kriterin 3, që duhet të largohet nga lista ndërsa në listë mbetin 4 punëtorë.

Bazuar në këto 5 pretendime Autoriteti Kontraktues në mënyrë të kundërligjshme ka shpallur Fitues një operator ekonomik i cili nuk ka përmbushur kërkesat në dosjen e tenderit dhe njoftimit për kontratë.

Përgjigje në pretendimin ankimor 5: Ekspertja shqyrtuese sqaron se autoritetit kontraktues tek kërkesat e Kapaciteti teknik dhe profesional ka kërkuar:

Kërkesa 2: Numri i punëtorëve të angazhuar në këtë projekt, min. 5 punëtor me të dhënat në vijim: Emri, mbiemrin, mosha e punëtorit, profesioni, eksperiencia (vite) dhe pozicioni në kompani;

Dëshmia e kërkuar dokumentare: Dëshmia 2: Lista e numrit të punëtorëve të angazhohen për kryerjen e shërbimeve, min. 5 punëtor me të dhënat në vijim: Emri, mbiemrin, mosha e punëtorit, profesioni, eksperiencia (vite), përshkrimin e shkurtër të vendit të punës dhe nënshkrimi i punëtorëve në atë listë – duhet të dorëzohet në origjinal, i nënshkruar dhe i vulosur nga Operatori Ekonomik, për secilin punëtor të prezantuar në listë duhet të dëshmohet, kontrata e punës me punëdhënësin ose marrëveshja mbi angazhim për këtë projekt;

Lidhur me kërkesë e AK-së, OE i rekomanduar për kontratë N.SH.T “Neziri-N”- Rahovec, së bashku me ofertë ka bashkangjitur dokumentin me titull: 7.Kapaciteti teknik dhe profesional kërkesa nr 2.-pjesa e pare.pdf dhe 7.Kapaciteti teknik dhe profesional kërkesa nr 2.-pjesa e dyte.pdf

Sa i përket pretendimit ankimor se njëri nga pesë punëtoret e prezantuar në listë nga OE i rekomanduar për kontratë është i përfshirë edhe tek kërkesa me numër 3 dhe duhet të largohet nga lista, ndërsa në listë mbetin 4 punëtorë, ku nuk plotësohet kërkesa e AK-së. Ekspertja shqyrtuese sqaron se kërkesa e AK-së ka qenë që OE të ketë së paku 5 punëtor, gjë që OE i rekomanduar ka prezantuar 5 punëtor. Sa i përket pikës ankimore se personi i njëjtë është edhe te kërkesa numër 3, ekspertja shqyrtuese sqaron se AK nuk ka përcaktuar ndonjë kufizim në kërkesë lidhur me rolin e punëtorëve, do të thotë AK nuk ka precizuar apo nuk ka kërkuar përmes kërkesës që secili prej këtyre 5 punëtorëve të ketë rol të veçantë, përveç personit me diplomë apo certifikatë të profesionit automekanik, gjë që OE i rekomanduar e ka caktuar personin me këtë certifikatë. Andaj, pretendimi ankimor i OE ankues është i pabazuar.

Pretendimi ankimor 6: Pretendimi ankimor lidhur me arsyen e eliminimit të ankuesit OE potencon se AK ka përdor standarde të dyfishta, ku për ato gjetje që ka eliminuar ofertën tonë ndërsa OE N.SH.T. "NEZIRI-N" ia ka pranuar pa i plotësuar ato kritere. Me rastin e eliminimit të kompanisë sonë duke mos kërkuar sqarim, shihet qartas që ka vepruar në kundërshtim me nenin 40.13 të Rregullores për prokurim publik. Ndërsa, duke e ditur që ne si tenderues kemi ofruar, ofertën më të mirë sipas kritereve për dhënien e kontratës, në bazë të nenit 45.33 të Rregullores për prokurim publik AK ka vazhduar vlerësimin e ofertës jashtë kritereve të cilat nuk kanë qenë të vendosura në dosjen e tenderit dhe njoftimin për kontratë. Ndërsa neni 59.4 i LPP-së gjithashtu lejon Autoritetin Kontraktues që të pranojë ofertat, në rast të gabimeve ose paqartësive dhe në raste të devijimeve të vogla. Në të dyja rastet është një kusht që të mos jetë në aspektin material të njoftimin për kontratë/dosjen e tenderit nuk janë prekur. Ndërsa duke u bazuar në Nenin 59-Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahësimi i tenderëve pika.2 AK ka mundur që të kërkojë sqarim me shkrim mbi cilindo nga aspektet e tenderit, në mënyrë që të bëhet Ekzaminimi, Vlerësimi ose Krahësimi i tenderëve sipas Ligjit, Udhëzuesëve dhe Rregulloreve. Komisioni i vlerësimit me rastin e vlerësimit ka bërë shkeljen e deklaratës nën betim Sipas

Neneve 1,11, 59 dhe 72 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 duke mos zbatuar detyrën për të cilën edhe e ka nënshkruar këtë deklaratë duke eliminuar kompaninë tonë për kritere të kanë mundur të kërkohet sqarim. Pra ne kemi dorëzuar tender i cili është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin për kontratë dhe dosje të tenderit dhe kemi ofertuar me tenderin me çmim më të ulët.

Përgjigje në pretendimin ankimor 6: Ekspertja shqyrtuese sqaron se bazuar në “Letrën standarde për tenderuesit e eliminuar” OE ankues është eliminuar nga ana e AK-së me arsyetimin:

Kapaciteti teknik dhe profesional:

Kërkesa 1: Operatori Ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka realizuara me sukses kontrata të natyrës së ngjashme, në tri vitet e fundit nga data e publikimit të Njoftimit për Kontratë, në vlerë min. 90,000.00 Euro;

Dëshmia e kërkuar dokumentare

Dëshmia 1: Lista e shërbimeve të realizuara, duke plotësuar ANEKSIN 8 të Dosjes së Tenderit, në lëmin e shërbimeve të ngjashme të realizuar në tri vitet e fundit nga data e publikimit të Njoftimit për Kontratë – duhet të dorëzohet në origjinal, i nënshkruar dhe i vulosur nga Operatori Ekonomik, DHE kësaj liste duhet ti bashkëngjiten si dëshmi

(i) kur shërbimi është bërë për një Autoritet Publik në Kosovë ose në një vend tjetër, për dëshmi të këtij livrimi shërben kopja e certifikatës (certifikata/raporti i përkohshëm i pranimit) të rëndësishme të lëshuar ose të bashkë-nënshkruara nga autoriteti i tillë, të gjitha këto dëshmi duhet të kenë vlerën e realizuar,

(ii) kur shërbimi është bërë për një blerës privat, për dëshmi të këtij livrimi shërben kopja e çdo dokumenti të nënshkruar nga blerësi dhe evidentimi i livrimit të tillë me dëshmi të pagesës nga banka;

Sqarimet janë si në vijim:

Në ofertën e juaj të dorëzuar si operator ekonomik NUK keni dorëzuar Listën e shërbimeve të realizuara duke plotësuar ANEKSIN 8 të Dosjes së Tenderit ku në Dosjen e Tenderit kemi cekur:

(Ky Aneks është obligativ që të plotësohet dhe ti bashkëngjiten certifikatat përkatëse ose ndonjë dokument tjetër që evidenton performimin e tillë), ku dokumenti në fjalë nuk mundë të kërkohet në bazë të nenit 72 par 3 të LPP-së ku thuhet: *Sigurimi i informacionit që mungon ose ofrimi i informacionit do të aplikohet vetëm për dokumentet ekzistenca e të cilave është e fiksuar, para skadimit të afatit për dorëzimin e tenderëve, dhe mund të verifikohet në mënyrë objektive.*

Referencat/raporti i përkohshëm i pranimit të dorëzuar nga Lideri i Konzerciumit; Gentian Sakaj B.I vlera që AK ka konstatuar si të pranueshme disa referenca të dorëzuara janë në vlerë prej;17,694.65 euro gjë që nuk përmbushë kërkesat e AK-së, pasi që vlera e kërkuar është min 90,000.00euro.

Ndërsa faturat e dorëzuara me blerës privat NUK janë të pranueshme pasi që nuk janë dorëzuar dëshmitë e pagesës nga Banka nga dëshmia e kërkuar dokumentare është cekur: *(ii) kur shërbimi është bërë për një blerës privat, për dëshmi të këtij livrimi shërben kopja e çdo dokumenti të nënshkruar nga blerësi dhe evidentimi i livrimit të tillë me dëshmi të pagesës nga banka;*

Anëtari i Konzerciumit Lirim Thaçi B.I ka dorëzuar po ashtu fatura me blerës privat por NUK janë të pranueshme pasi që nuk janë dorëzuar dëshmitë të pagesës nga Banka nga dëshmia e kërkuar dokumentare është cekur: *(ii) kur shërbimi është bërë për një blerës privat, për dëshmi të këtij livrimi shërben kopja e çdo dokumenti të nënshkruar nga blerësi dhe evidentimi i livrimit të tillë me dëshmi të pagesës nga banka;*

Andaj oferta e juaj konsiderohet e papërgjegjshme konform LPP-së.

Kapaciteti teknik dhe profesional:

Kërkesa 5: Operatori Ekonomik duhet të posedoj hapësirë të mjaftueshme (garazhe) për servisim të automjeteve. Kjo hapësirë duhet të jetë e mbyllur dhe e mbrojtur nga ndikimet e faktoreve të jashtëm siç janë reshjet, era, pluhuri, etj., min. 100 m² dhe hapësirë përcjellëse – parking të obligueshëm. Operatori Ekonomik të ketë garazhen jo më larg se 15 km nga objekti i Komunës së Rahovecit;

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

Dëshmia 5: Hapësira e objektit të dëshmohet me Vërtetimin e tatimit në pronë, fletë poseduese, fotografi, skicë apo dokumentacion tjetër dëshmues për pronësi ose marrëveshje me qera e garazhes, Marrëveshja duhet të jete në emër të këtij projekti me validitet të kohëzgjatjes të kësaj kontrate e nënshkruar dhe vulosur nga të dyja palët, po ashtu duhet të dorëzohet deklarate me shkrim nga kompania se ku gjendet pika me e afërt Garazhës Punëtorisë nga Komuna e Rahovecit;

Sqarimet janë si në vijim:

Sipas Aneksi 7 DEKLARATA PER THEMELIM TE GRUPIT, ku në bazë të kësaj deklarate deklarojnë %(përqindjen) e pjesëmarrjes në realizimin e kontratës nga lideri Gentian Sakaj B.I, ka dorëzuar marrëveshje me qere të garazhes dhe ka dorëzuar se ku gjendet pika me e afërte e garazhës/punëtorisë nga komuna e Rahovecit, por NUK, janë dorëzuar dokumentet tjera në bazë të dëshmisë së kërkuar dokumentare siç janë: *Vërtetimin e tatimit në pronë, fletë poseduese, fotografi, skicë apo dokumentacion tjetër dëshmues për pronësi*, andaj oferta juaj konsiderohet e papërgjegjshme konform LPP-së.

Po ashtu Aneksi 7 DEKLARATA PER THEMELIM TE GRUPIT, ku në bazë të kësaj deklarate deklarojnë %(përqindjen) e pjesëmarrjes në realizimin e kontratës 40% e pjesëmarrjes në realizimin e kontratës nga lideri; Lirim Thaçi B.I NUK ka dorëzuar asnjë dëshmi sipas kerkese 5 të njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderi, andaj oferta juaj konsiderohet e papërgjegjshme konform LPP-së.

Ekspertja shqyrtuese, bazuar në letrën standarde për eliminimin e OE ankues vlerëson se AK ka dhënë arsye të qarta për secilën pikë të eliminimit të ofertës së OE ankues, për shkak të mosplotësimit të kërkesave sipas njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit.

Ekspertja shqyrtuese vlerëson se përderisa OE ankues nuk ka plotësuar kërkesën nr.1 të kapacitetit teknik dhe profesional përkatësisht dëshminë lidhur me këtë kerkese AK nuk ka mundur të kërkojë sqarime nga OE, vlen të theksohet se AK tek dosja e tenderit në faqen 27 ka specifikuar se ky Aknes është obligativë që të plotësohet gjë që OE ankues nuk e ka bërë. Ekspertja shqyrtuese sqaron se operatorët ekonomik të cilët shprehin interes për një aktivitet të prokurimit janë përgjegjës për ngarkimin dhe plotësimin e të gjitha dokumenteve të kërkuara në dosjen e tenderit në sistemin e prokurimit para afatit të fundit për dorëzimin e tenderëve për të dëshmuar se plotësojnë kërkesat dhe kriteret e përcaktuar në dosjen e tenderit. Këtë konstatim, ekspertja shqyrtuese e bazon në nenin 32, par. 32.4 të Rregullores Nr. 001/2022 Për Prokurimin Publik. Megjithatë, AK ka mund që të kërkojë sqarime shtesë OE-së ankues në bazë të nenit 72 të LPP-së, për disa nga pikat e eliminimit por me qenes OE nuk ka plotësuar Aneksin 8 të dosjes së tenderit atëherë sqarimet e tilla nuk do ndryshonin rezultatin nenin 59, par. 4 të LPP-së: *“Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit...”*

Ekspertja shqyrtuese sqaron se pas analizimit të dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontratë rezulton se as njëri nga operatorët ekonomik nuk i plotësohen kërkesat e dosjes së tenderit ashtu siç u sqarua me lart. Po ashtu sqarojmë se bazuar në shkresat e lëndës për këtë aktivitet të prokurimit kanë ofertuar gjithsej dy (2) operatore ekonomik të cilët kane dorëzuar oferta të pa përgjegjshme që nuk i plotësojnë kërkesat e AK-së, Andaj në mbështetje të asaj që u përshkrua si më lartë, vlerësimi ynë është se vlerësimi i ofertave nuk është bërë në harmoni me nenin 59 të LPP-së. Andaj rekomandoj që ky aktivitet i prokurim të anulohet në mungesë të ofertës së përgjegjshme, ndërsa ankesa e OE ankues të aprovohet pjesërisht si e bazuar për arsyet të dhëna në përgjigje të pretendimit me numër një.

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues –

Paneli shqyrtues në mënyrë të pavarur dhe objektive, me ndërgjegje dhe kujdes profesional ka vlerësuar të gjitha provat e rastit. Në këtë mënyrë në bazë të konstatimeve të ekspertit shqyrtues, konstatime këto të cilat Paneli Shqyrtues ju fal besimin, është gjetur se Autoriteti Kontraktues nuk ka vepruar në përputhje me dispozitat ligjore për prokurimin publik dhe kërkesat e Dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit Mirëmbajtja dhe Servisimi i automjeteve me numër të prokurimit 623-25-4014-2-2-1.

Paneli shqyrtues pas administrimit dhe vlerësimit të provave, konstatimit të plotë të gjendjes faktike, duke u mbështetur në LPP si ligj material të zbatueshëm, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe rekomandimet e ekspertit shqyrtues, ka gjetur se ankesa e Operatorit Ekonomik aprovohet si pjesërisht e bazuar. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues ka vendosur lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull Mirëmbajtja dhe Servisimi i automjeteve me numër të prokurimit 623-25-4014-2-2-1, të

anulohet njoftimi për dhënie të kontratës nëse AK më tutje ka interes për aktivitetin e prokurimit mund ta ri tenderoj.

Paneli Shqyrtues duke marre parasysh përshkrimin dhe faktet e lartpërmendura dhe pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të operatorit ekonomik ankues, analizës konkrete dhe dokumentacionit të lëndës, ankesën e operatorit ekonomik e sheh si pjesërisht të bazuara, duke rekomanduar që aktiviteti i prokurimit me titull Mirëmbajtja dhe Servisimi i automjeteve me numër të prokurimit 623-25-4014-2-2-1 të kthehet në ritenderim si dhe AK të veproj në harmoni me dispozitat ligjore të LPP-së dhe kërkesat e dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontratë.

Panelit Shqyrtues ka vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës. Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Për pikën I të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 117 të LPP lidhur me nenin 29 dhe 31 paragrafin të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën II të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 131 të LPP lidhur me nenin 29 paragrafin 3 të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën III të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 31 paragrafin 4 dhe paragrafin 6 të Rregullores së Punës së OSHP lidhur me nenin 118 të LPP.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

Vedat Poterqoi

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendi mi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës Komerciale - Departamentit për çështje Administrative për anulim vendimi në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KUVENDI KOMUNAL - RAHOVECË**
- **OE - Gentian Sakaj B.I.**
- Arkivës së OSHP-së: